



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 maj 2012  
Nr. ref.: RK244/12

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI 108/11**

Parashtruesi

**Myrteza Dyla**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme PN. Nr.  
372/2011, të 13 korrikut 2011**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Myrteza Dyla, i përfaqësuar nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme PN. Nr. 372/2011, të 13 korrikut 2011, i cili i është dorëzuar më 22 korrik 2011.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme PN. Nr. 372/2011, të 13 korrikut 2011, me të cilin gjoja i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E drejta për Mjete Juridike] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 8 gusht 2011.
6. Më 23 gusht 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI 108/11, e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Po të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI 108/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Gjyljeta Mushkolaj.
7. Më 24 janar 2011, Gjykata ua komunikoi kërkesën Gjykatës Supreme dhe Prokurorit publik të qarkut në Pejë. Gjykata nuk ka marrë asnjë përgjigje deri më tani.
8. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues më 4 maj 2012 dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

## **Përmbledhje e fakteve**

9. Më 15 qershor 2011, një gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Pejë (në tekstin e mëtejme: gjyqtari) e konfirmoi aktakuzën e Prokurorit publik të Qarkut të paraqitur ndaj parashtruesit të kërkesës për kryerje të veprës penale nga neni 339.3 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal (në tekstin e mëtejme: KPK) (Vendimi KA. nr. 90/11). Gjyqtari konfirmoi se kishte bazë të mjaftueshme për konfirmim të aktakuzës në mënyrë që të konstatohej fajësia ose pafajësia e parashtruesit në shqyrtimin kryesor. Parashtruesi ushtroi ankesë ndaj këtij vendimi në Kolegjin prej tre gjyqtarësh të Gjykatës së Qarkut në Pejë (në tekstin e mëtejme: Kolegji).
10. Më 27 qershor 2011, Kolegji e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të papranueshme (Vendimi KA. nr. 90/11) dhe konkludoi që ankesa ndaj vendimit të gjyqtarit në lidhje me konfirmimin e aktakuzës do të mund të parashtrohej vetëm nga prokurori dhe pala e dëmtuar kur aktakuza hedhet poshtë sipas nenit 317.2 të KPK-së. Parashtruesi u ankua ndaj këtij vendimi në Gjykatën Supreme.

11. Më 13 korrik 2011, Gjykata Supreme e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe konkludoi, mbi të njëjtën bazë sikurse edhe Kolegji, që ankesa ndaj vendimit të gjyqtarit në lidhje me konfirmimin e aktakuzës do të mund të parashtrohej vetëm nga prokurori dhe pala e dëmtuar kur aktakuza hedhet poshtë sipas nenit 317.2 të KPK-së (Vendimi Pn. Nr. 372/2011).

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se:
  - a. Është shkelur e drejta për ankesë sepse parashtruesi nuk ka mundur të ankohej ndaj vendimit të gjyqtarit në lidhje me konfirmimin e Aktakuzës së 15 qershorit 2011;
  - b. Është shkelur edhe e drejta e qasjes në gjykatë duke mos ia dhënë mundësinë parashtruesit që të ankohej;
  - c. Është shkelur parimi i barazisë së armëve në mes palëve në procedurë;
  - d. Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme gabimisht e kanë zbatuar dhe interpretuar KPK-në sepse, sipas parashtruesit, ekziston e drejta e ankesës sipas KPK-së.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E drejta për Mjete Juridike] dhe 102 [Parimet e përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së.
14. Sa u përket ankesave të parashtruesit, Gjykata vëren se, për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, ajo së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
15. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese thekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).
16. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).
17. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë pasi nuk i është lejuar të ushtrojë ankesë ndaj vendimit të gjyqtarit për konfirmimin e aktakuzës.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 102.5 të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe.”* Neni 317.2 i KPPK nuk parashikon të drejtën e parashtruesit që të ankohet ndaj konfirmimit të aktakuzës. Megjithatë, Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme e morën parasysh ankesën e parashtruesit, por vendosën që nuk mund të ushtrohej ankesë ndaj konfirmimit të aktakuzës sipas nenit 317.2 të KPPK-së, i cili përcakton:

*“Ndaj aktvendimit të gjyqtarit për hudhjen e aktakuzës mund të ushtrohet ankesë nga prokurori dhe i dëmtuari në kolegjin prej [tre] gjyqtarësh.”*

19. Përveç kësaj, Gjykata vëren që konfirmimi i aktakuzës nuk paragjykon gjykimin e çështjes gjatë shqyrtimit kryesor në përputhje me nenin 317.1 të KPPK-së, i cili përcakton:

*“Të gjitha aktvendimet e marra nga gjyqtari lidhur me konfirmimin e aktakuzës duhet të arsyetohen në atë mënyrë që të mos prejudikohet gjykimi i çështjeve të cilat do të shqyrtohen në shqyrtimin gjyqësor.”*

20. Në fakt, parashtruesi nuk e ka mbështetur kërkesën në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga ai organ publik. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
21. Prandaj, rezulton që kërkesa është qartazi e pabazuar në përputhje me rregullin 36.1 (c) të Rregullores së punës, i cili thotë: *“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar”*.
22. Nëse kjo Gjykatë merr parasysh faktin që parashtruesi i kërkesës e ngrit çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, në këtë rast të KPPK-së, Gjykata vëren që vetëm palët e autorizuar sipas nenit 113.2 të Kushtetutës kanë të drejtë ta ngrënë këtë çështje. Prandaj, parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar sipas nenit 113.2 të Kushtetutës. Megjithatë, parashtruesi mund ta ngrejë çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën në gjykata të rregullta, të cilat janë të autorizuar, sipas nenit 113.8 të Kushtetutës, t'i referojnë këto çështje në Gjykatën Kushtetuese.
23. Prandaj, kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, rregullin 36.1 (c) dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, më 4 maj 2012, Gjykata Kushtetuese njëzëri:



### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović



Prof. Dr. Enver Hasani

